

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 20 TETOR 2022

Jo, zonjë, kam 11 minuta.

Natyrisht, ju do të donit të mos kisha asnjë minutë, por zërin tim dhe të vërtetat që unë u them shqiptarëve ju nuk mund t'i pengoni kurrë dhe asnjëherë me asgjë.

Sot diskutojmë për një sektor, i cili është rasti më klasik se si një pasuri kombëtare është shndërruar në një mallkim kombëtar për qytetarët shqiptarë.

Por pse një pasuri kombëtare? Një pasuri e çmuar kombëtare, me të cilën, falë një strategjie të nisur në vitin 2007, u arrit të mbidfishohej prodhimi i energjisë nga burimet ujore të vendit. Është fakt që në 6-mujorin që kaloi 54% e energjisë së vendit është prodhuar nga HEC-et private; është fakt që në vitin 2021, Shqipëria prodhoi 9 terravat energji, nga e cila konsumon vetëm 7.

Fati tjetër tragjik është se biznesi i vogël shqiptar paguan tarifat më të larta në Europë falë rritjes katastrofike që u bëtë ju atyre tarifave.

Fakti tjetër është se është shndërruar në një mallkim për qytetarët shqiptarë, se po vidhni në mënyrën më të papërmbytur, sepse, si në asnjë vend tjetër, e shisni energjinë e digave tek agjentët tregtarë tuaj me 40 euro megavati, dhe po ky agjent e shet në bursë me 140 euro dhe ju sjell të gjithë fitimin që keni përcaktuar së bashku me të.

Fakti është se ju merrni në pikun e energjisë energji nga Kosova, nga KEK-u, me qëllim që ta depozitoni këtu dhe t'ia ktheni kur të keni. Ju atë energji, në vend që të mbyllni digat dhe të rrisni rezervën, e rieksporoni dhe hapni digat vetëm e vetëm për të përfituar dhe vjedhur.

Ju keni krijuar në sistemin energjetik një rrjet vjedhjes ndër më gjigandët në Europë dhe botë. Ju hapni tenderë në një platformë digjitale të paverifikuar nga askush, përveç grupit të hajdutëve me të cilët vidhni. Këtë tender e hapni nga ora 12 dhe mbyllni nga ora 3 për 320 milionë euro. Hap e mbyllë sytë, fap e fap, shpallet fituesi me 99,99 për qind, i pashpallur me siguri. Ju vidhni e vetëm vidhni.

Ju keni instaluar kohët e fundit një sistem vjedhjeje të qytetarëve në pallatet private të vjetra. OSHEE-ja ka urdhëruar që t'u faturohet pallateve të vjetra pa ashensor, pa pompa uji, që kanë gjithsej vetëm 5 llamba 20-kilovatëshe dhe që konsumojnë në 24 orë maksimumi i maksimumit 40 kilovatë në orë, ju i faturoni 600 kilovat në orë. Çdo familje duhet të paguajë vjedhjen tuaj, ndërkohë thoni se keni ulur humbjet. Ju jo vetëm që nuk keni ulur humbjet, se humbje, gropë e zezë, jeni ju si qeveri, por nuk paguani tarifat e konsumit të energjisë nëpër institucione. Nuk janë 1 apo 2, por janë 200 milionë euro para të taksapaguesve, që ju i bëni orgji dhe vidhni në drejtime të tjera.

Pra, si mund të kthehet ndryshe një pasuri e çmuar kombëtare në një mallkim kombëtar, siç është shndërruar energjia për shqiptarët?!

Në qoftë se ti, i pafytyrë, që je aty, do të ndërhysh në fjalën time...

Zonjë, ju kanë zgjedhur Kryetare parlamenti, të të respektojnë ty në radhë të parë...

Ai bëhet kryetar parlamenti, por çfarë pune ka ai?! Këtu ka një Kryetare parlamenti, dhe, në qoftë se nuk e bëni dot ju detyrën, le t'ju shkarkojnë, por deri në momentin që ju jeni aty, duhet të respektoheni.

Edhe një herë, ky është mekanizmi i shndërrimit në mallkim kombëtar të një pasurie mahnitëse.

Dua të them dy fjalë për atë që tha zonja, e cila nuk ka as sy të shikojë dhe as veshë të dëgjojë, sepse ia ka zënë hajnia.

Së pari, ato që janë bërë nga qeveria para jush janë epokale. Është bërë një betejë epike me gazin rus dhe është sjellë në Shqipëri dhe në Europë gazi azer me kapacitet 20 miliardë metër/kub në vit.

Së dyti, janë licencuar dhe ndërtuar nga ajo qeveri dhe në vazhdim nga sektori privat 432 hidrocentrale, të gjitha me teknologji *lege artis*.

Së treti, harroje Skavicën! Kur ta mbysësh ti Dibrën, do të zgjohen Enver Hoxha dhe Beqir Balluku nga varret. Kurrë nuk do e përmbysësh Dibrën ti!